



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:186928
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05316624

C.nr. 2664/10

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Argzon Muçaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional D.Th., në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.B. nga P., Rr. "K.L.", nr..., kundër të paditurve P.Zh. më parë nga P., tani me vendbanim të panjohur dhe Sh.I. nga P., Rr. "K.", p.n., lidhur me çështjen juridike kontestimore vërtetimi i të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas propozimit për kthim në gjendje të mëparshme i paraqitur nga trashëgimtarët e paditëses M.B., Z.B., M.B. dhe B.B. që të gjithë nga P., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson E.A., avokat nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pas afatshëm propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme, i datës 28.08.2023, i paraqitur nga trashëgimtarët e paditëses F.B. nga P., dhe atë: M.B., Z.B., M.B. dhe B.B. që të gjithë nga P., përmes përfaqësuesit të autorizuar E.A., avokat nga Prishtina.

A r s y e t i m

Në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata në përputhje me nenin 116 paragraf 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tani e tutje LPK), përmes aktvendimit të datës 24.04.2023, kishte vendosur që komunikimet me palën paditëse F.B. nga P. të bëhen përmes publikimit, përkatësisht afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Në vijim të procedurës gjyqësore, gjykata kishte caktuar seancën përgatitore me datë 10.05.2023, ku palës paditëse ftesën për seancë i kishte komunikuar përmes tabelës së shpalljeve të gjykatës në përputhje me aktvendimin e datës 24.04.2023, ashtu që ftesa për këtë seancë ishte publikuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës me datë 24.04.2023, ndërsa është tërhequr nga tabela me datë 10.05.2023, me çka konstatohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal, e cila është pjesë e dosjes së lëndës. Seanca përgatitore ishte mbajtur me datë 10.05.2023, në të cilën seancë nuk kishte marr pjesë pala paditëse, dhe gjykata e kishte konsideruar të tërhequr padinë.

Trashëgimtarët e paditëses M.B., Z.B., M.B. dhe B.B. që të gjithë nga P., përmes përfaqësuesit të autorizuar E.A., avokat nga Prishtina, me datë 28.08.2023 në këtë gjykatë kanë paraqitur

propozim për kthim në gjendje të mëparshme, përmes të cilit kanë shtuar se paditësja tani e ndjera F.B. ka vdekur me datën 21.10.2017 dhe pasardhësit gjegjësisht fëmijët e saj as që kanë pasur njohuri që e ndjera ka paraqitur padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Më tutje, kanë shtuar se pasardhësit e të ndjerës nuk kanë pasur njohuri lidhur me seancën e caktuar nga gjykata, për çka nuk janë paraqitur në seancën e datës 05.04.2023, mirëpo, pas marrjes në dijeni se është duke u zhvilluar procedura në gjykatë dhe gjykata me aktvendimin C.nr.2664/10 të datës 10.05.2023 e ka konsideruar të tërhequr padinë në këtë çështje juridike duke konsideruar se të njëjtën e ka ftuar në mënyrë të rregullt kanë kompletuar dokumentacionin se bashku me dëshminë e vdekjes dhe kanë paraqitur propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme.

Nga gjykata kanë kërkuar që propozimi të aprovohet dhe aktvendimi për tërheqjen e padisë i datës 10.05.2023 të anulohet, dhe këtë u bazuar në të drejtën për një gjykim të drejtë dhe ligjor, i përcaktuar dhe garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Lirit e Njeriut dhe Protokollat e saj, e në pajtim me dispozitat e nenit 130 paragraf 2 dhe 133 paragraf 2 lidhur me nenin 129 paragraf 1 të LPK-së.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e analizoi dhe e vlerësoi propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme, dhe arriti në përfundim se i njëjti është paraqitur pas afatit ligjor.

Ligji i Procedurës Kontestimore në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 130 lidhur me afatin për kthimin në gjendjen e mëparshme, parasheh se propozimi duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e po qe se pala me vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin, ndërsa, pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme. Dispozita e lartcekur, bënë ndarjen e afateve në afate subjektive dhe objektive.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me afat objektiv, për faktin se gjykata nuk ka prova nëse trashëgimtarët kanë qenë të njoftuar lidhur me procedurën gjyqësore sipas padisë së paditëses, e po ashtu, në propozimin për kthim në gjendje të mëparshme, nuk përmendet momenti dhe mënyra e vënies në dijeni.

Fillimisht, në raport me afatin për paraqitjen e propozimit për kthim në gjendje të mëparshme, gjykata konstatoj se ky afat ka filluar të rrjedh me datë 10.05.2023, moment ky kur është mbajtur seanca përgatitore, në të cilin gjykata ka marr aktvendim me të cilin e konsideron të tërhequr padinë e paditëses. Meqenëse, në rastin konkret kemi të bëjmë me afat objektiv, ky afat ka filluar të rrjedh nga kjo datë, sipas dispozitës së lartcekur i njëjti afat është 60 ditë, ndërsa, afati i fundit për paraqitjen e propozimit ka qenë data 10.07.2023, kurse, propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është paraqitur me datë 28.08.2023, rrjedhimisht 48 ditë pas kalimit të këtij afati ligjor.

Në raport me afatin objektiv, gjykata vlerëson se nuk vlen momenti i njoftimit apo vënies në dijeni të palës për të ndërmarr veprime, por vendimtare është kalimi i kohës së caktuar, përkatësisht paraqitja e propozimit për kthim në gjendje të mëparshme brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, nga momenti i mos veprimit, ndërsa pas kalimit të këtij afati nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

Në rastin konkret, mosveprim nënkupton mungesa e palës në seancën e datës 10.05.2023, dhe në këtë rast zbatohen dispozitat nga neni 126 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, sipas të cilave dispozita afati objektiv fillon në ditën e parë pas ditës së mbajtjes së seancës përgatitore, në të cilën seancë është konsideruar e tërhequr padia, përkatësisht me datë 10.05.2023.

Gjykata vlerëson se afati gjashtëdhjetë (60) ditë është afat prekluziv dhe respektimi i afateve procedurale të përcaktuara me ligj është qellim legjitim i ndërlidhur me parimin e sigurisë juridike dhe administrimin e duhur të drejtësisë, dhe në rastin konkret trashëgimtarët e paditëses e kanë humbur të drejtën për kryerjen e veprimeve procedurale brenda afateve ligjore.

Me nenin 133 paragraf 1 të LPK-së, parashihet se: *“Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit”*, në përputhje me këtë dispozitë e duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konstaton se propozimi është paraqitur pas afatit dhe të njëjtin e hedhi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 2664/10, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.